29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kuriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të pareaizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktojnë jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-23-636-5-1-1/C750

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj. Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës sipas urdhërësës me shkrim nga menaxheri i projektit
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 200 ditë pune, brenda 24 muajve nga nënshkrimi i kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e

		Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 37 muaj pas pranimit të punëve të kryera.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Numri i Prokurimit: 632-23-636-5-1-1 – Titulli Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit


PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	"LIKA TRADE" SH.P.K
Adresa	Isniq-Deçan
Qyteti	Deçan
Kodi Postar	51000
Kontakti	Sali Likaj
Telefoni	044/179-343
Fax	/
E-mail	likatrade@hotmail.com
Numri i TVSH	330084476

BANKA	
Emri	NLB-BANKA
Adresa	Rr.Ukshin Hoti Nr 124 Prishtinë
Qyteti	Deçan
Kodi Postar	51000
Shteti	Republika e Kosovës
Llogaria Bankare	1705200005011994
IBAN (opcionale)	XK05 1705200005011994
BIC (Opcionale)	NLPR XK PR

SHËNIME:

VULA E BANKËS + NËNSHIKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme)



DATA + NËNSHIKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)



Projekti Kryesor i zgjerimit të rrugës hyrja nga Deçani, Gjakovë

Paramasa dhe Paralogaria

AKSI 3

Rruga L=1+998.54 km

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punët Pregaditore				
1	Punët pregaditore për fillimin e punimeve, mobilizimi i punishtes me zyre dhe shenjat e nevojshme për siguri dhe paralajmërim të vendpulishtës. (Zyra të ketë kushte të mira për punë të jete e paisur me inventar, printer, internet, të ketë tavolin shtesë - të veçant për projekt menaxherin dhe organin mbikëqyrës)	komplet	1.00	15,000.00	15,000.00 €
2	Pastrimi i terrenit kontrollimi i instalimeve nëntokësore dhe largimi të gjitha pengesave të ndryshme në trasen e rrugës. Në rastet demtimi të instalimeve ekzistuese (që janë të bashkangjitur në projekt nga kompanitë regjionale) duhet të rregulloj vetë punëkryesi	m'	1,998.54	8.00	15,988.32 €
3	Shenjëzimi i trasës dhe përcjellja e punimeve me gjeodet.	m'	1,998.54	5.00	9,992.70 €
4	Demolimi dhe rivendosja e rrethojës (rrethoj tel me gjemba)	m'	465.00	3.00	1,395.00 €
5	Ngritja dhe nivelizimi i kapakut të pushtave ekzistuese të kanalizimit. Në këtë pozicion janë të përfshirë të gjitha punët e nevojshme të ngritjes së kapakut të pushtave deri në 42 ton.	copë	15.00	100.00	1,500.00 €
6	Ngritja dhe nivelizimi i kapakut të pushtave ekzistuese të kanalizimit. Në këtë pozicion janë të përfshirë furnizimi kapakut dhe të gjitha punët e nevojshme të ngritjes së kapakut të pushtave deri në 42 ton.	copë	5.00	300.00	1,500.00 €
7	Ngritja dhe nivelizimi i kapakut të pushtave ekzistuese të instalimeve nëntokësore. Në këtë pozicion janë të përfshirë të gjitha punët e nevojshme të ngritjes së kapakut të pushtave deri në 42 ton.	copë	6.00	150.00	900.00 €
8	Ngritja dhe nivelizimi i kapakut të pushtave ekzistuese të instalimeve nëntokësore. Në këtë pozicion janë të përfshirë furnizimi dhe të gjitha punët e nevojshme të ngritjes së kapakut të pushtave deri në 42 ton.	copë	3.00	300.00	900.00 €



9	Largimi dhe dislokimi i shtyllave ekzistuese nga druri dhe zëvendësimi i tyre me shtylla të betonit me lartësi H=9m këndore tip 40°, me bazament të betonit duke përfshirë germimin për bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m (si dhe largimi i dheut të germuar në deponinë e caktuar nga Investitori max 15 km), vendosjen e betonit, shiritin e tokezimit Fe/Zn 25x4mm(3.5mm), reren e imet, montimin e unazës, vendosja e konzollës (për rrjet ajror 0.4kV), trupave ndriçues (nese ekziston) si dhe demontimi dhe montimi i serishem i kabllove ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshëm komplet me ateste për një shtyllë të dislokuar.	cope	25.00	250.00	6,250.00 €
10	Dislokimi i shtyllave ekzistuese të betonit me lartësi H=9m këndore tip 40°, me bazament të betonit duke përfshirë germimin për bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m (si dhe largimi i dheut të germuar në deponinë e caktuar nga Investitori max 15 km), vendosjen e betonit, shiritin e tokezimit Fe/Zn 25x4mm(3.5mm), reren e imet, montimin e unazës, vendosja e konzollës (për rrjet ajror 0.4kV), trupave ndriçues (nese ekziston) si dhe demontimi dhe montimi i serishem i kabllove ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshëm komplet me ateste për një shtyllë të dislokuar.	copë	5.00	150.00	750.00 €
11	Demolimi i shtyllave ekzistuese të ndriçimit me gjitha elementet përcjellëse dhe deponimi në vendin e caktuar nga Investitori max 15 km	copë	34.00	100.00	3,400.00 €
12	Largimi i kubzave nga betoni në trotualet ekzistuese së bashku me skajor, nese nuk i marrin pronaret atëherë deponohen në vendin e caktuar nga Investitori max 15 km	m ²	3,440.00	2.50	8,600.00 €
13	Largimi i hyrjeve nga beton-armesë dhe nga pllakat nga guri në trotualet ekzistuese dhe së bashku me skajor deponimi në vendin e caktuar nga Investitori max 15 km	m ²	2,200.00	3.00	6,600.00 €
14	Demolimi i mureve të parapetit (t=20 ÷ 40 cm) me lartësi (t=30 ÷ 50 cm) ekzistuese dhe deponimi në vendin e caktuar nga Investitori max 15 km	m ³	450.00	15.00	6,750.00 €
15	Inçizimi dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar (në rast të ndryshimit nga gjendja e projektuar)	m ³	1,998.54	1.00	1,998.54 €
Gjithsej totali me TVSH					81,524.56 €
II	Punët e Gërmimit				
1	Gerryerja e asfaltit dhe deponimi në vendin e caktuar nga investitori. Rruga ka dy shtresa asfalt dhe atë me trashësi 8+4 cm. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sipërfaqja e asfaltit të bizniseve private Nëse në hapsira të caktuara lajmërohen kubza nga graniti, kubzat e granitit deponohen në vendin e caktuar nga Investitori max 15km	m ²	16,688.00	5.00	83,440.00 €



2	Gërmimi i shtresave të rrugës ekzistuese në trupin e rrugës. Shtresat ekzistuese janë nga zhavori i lumit tmes=40 cm. Materiali gurorë duhet të deponohet në vendin e caktuar nga investitori, ndërsa materiali i gërmuar nën shtresat e trupit të rrugës duhet të transportohet në deponin e caktuar nga Investitori deri në 5 km. Në këtë pozicion është llogaritur edhe largimi i bankinës në dy anet e rrugës nga guri. Nëse në hapsira të caktuara lajmërohen kubza nga graniti, kubzat e granitit deponohen në vendin e caktuar nga Investitori	m³	10,793.00	1.25	13,491.25 €
1	Gërmimi i dheut të kategorisë III-IV në trupin e rrugës dhe në sanimin e trupit ekzistues në vendet ku është e nevojshme, bartja e tij në deponin e caktuar nga Investitori deri në 15 km	m³	41,332.60	4.50	185,996.70 €
2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv 25-30 MPa.	m²	53,965.50	0.50	26,982.75 €
Gjithsej totali me TVSH					309,910.70 €
III	Punët e Zhavorit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë rrethor mbushës 50-400 mm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >50 MPa. Në këtë pozicion është llogaritur materialit mbushës për sanimin e pjesëve të trasës me aftësi mbajtëse të dobët	m³	5,030.00	14.00	70,420.00 €
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë zhavorit 0-150mm t=40cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >70 Mpa	m³	15,020.95	14.00	210,293.30 €
3	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-63 mm, t=25cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv>90 MPa	m³	13,944.50	14.00	195,223.00 €
4	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31.5 mm t=15cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >120MPa	m³	6,157.98	15.00	92,369.70 €
5	Furnizimi, shtrirja dhe kompaktimi i zhavorit (material shterp nga gurthuesit) për punimin e bankinave, t=8 cm.	m³	230.50	3.00	691.50 €
6	Furnizimi, shtrirja e gjeotekstilit 400 gr/m2 Naue ose të ngjashme në nënbazën rrugës (gjeotekstili duhet të vendoset sipas rregullave teknike me palim minimum 40 cm). Në cmim duhet të llogaritet edhe rera për mbrojtje të gjeotekstilit me trashësi 5cm.	m²	49,950.00	1.50	74,925.00 €
Gjithsej totali me TVSH					643,922.50 €
IV	Punët e Betonit (Guret Skajor dhe Kubzat)				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e rrerës 10-40mm, d=5cm (në gjendje të ngjeshur)	m³	470.50	15.00	7,057.50 €
2	Furnizimi dhe montimi i Gurve Skajor nga betoni 18/24 cm, të klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin dhe mbushjen e fugave me llaj qimentoje si dhe perpunimin e tyre. Gjeresia e fugave të jete 12mm (±2mm))	m'	8,254.20	15.00	123,813.00 €
3	Furnizimi dhe montimi i Gurve Skajor nga betoni 10/20 cm, të klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin dhe mbushjen e fugave me llaj qimentoje si dhe perpunimin e tyre. Gjeresia e fugave të jete 12mm (±2mm))	m'	6,515.50	8.00	52,124.00 €



4	Furnizimi dhe montimi i kubzave nga betoni me trashësi t=6cm për trotuare. Kubzat duhet të jenë të klasës C-30/37. Ngjyra dhe modeli të zgjidhen nga Investitori.	m ²	11,618.00	13.00	151,034.00 €
5	Furnizimi dhe montimi i kubzave për paralajmrim të kalimeve të kembesoreve për persona me shikueshmeri të dobësuar. Ngjyra dhe modeli të zgjidhen nga Investitori.	m ²	42.00	44.00	1,848.00 €
6	Furnizimi dhe rrafshimi dhe perpunimi i dheut për oaza gjelbëruese t=20cm. Në çmim të përfshihet edhe humusimi i shtresës së sipërme dhe mbjellja e barit 100gr/m ² .	m ²	4,279.00	3.50	14,976.50 €
7	Furnizimi dhe montimi i rrethojës metalike për mbrojtje të kembesoreve përreth kanalit. Rrethoja ka lartësi h=1.4m. Në këtë pozicion të parashihet edhe ngjyrosja në tri shtrasa (baza dhe dy shtresa tjera)	m ²	455.00	35.00	15,925.00 €
Gjithsej totali me TVSH					366,778.00 €
V	Punët e Asfaltit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit BA 0/22 mm në rrugë, t=8cm	m ²	32,040.00	10.80	346,032.00 €
2	Furnizimi dhe spërkatja (lyrja) e shtresës së parë të asfaltit me emulsion, 0.5 litra për m ²	m ²	32,040.00	1.00	32,040.00 €
3	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit AB 11 s mm në rrugë dhe kyçje e rrugëve ekzistuese, t=4cm (zhavori duhet të jetë nga guri eroptiv)	m ²	32,040.00	6.00	192,240.00 €
Gjithsej totali me TVSH					570,312.00 €
VI	Punët e tjera				
1	Furnizimi dhe mbjellja e fidaneve të drunjëve dekorativ. Në këtë pozicion përfshihet hapja e gropës, mjellja e fidaneve, mbulimi me dhe, pleherimi si dhe punimi i rrethojës rreth bazës së fidanit. Lloji i drurit përcaktohet nga investitori. Lartësia minimale e fidanit duhet të jetë 2m. Drunjët të mbillen afërsisht çdo 8m (llojin e drunjëve të zgjedhë Investitori)	copë	400.00	25.00	10,000.00 €
2	Furnizimi dhe vendosja e kornizës mbrojtëse metalike-jo koroduese (1.20x1.20)m rreth bazës së pemeve, për mbrojtjen e rrënjës dhe mundesin e rrjedhjes së ajrit dhe ujit. Grila duhet të siguroj një sipërfaqe të përshtatshme për kembesoret. Modeli të zgjidhet nga investitori	copë	400.00	50.00	20,000.00 €
Gjithsej totali me TVSH					30,000.00 €
VII	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit				
1	Testimet e Ngjeshmëris	komplet	1.00	2,000.00	2,000.00 €
2	Testimet e gurëve skajorë dhe kubzave	komplet	1.00	500.00	500.00 €
3	Testimet e Asfaltit	komplet	1.00	2,000.00	2,000.00 €
4	Testimet e Kubzave të betonit	komplet	1.00	200.00	200.00 €
Gjithsej totali me TVSH					4,700.00 €

Rekapitullimi		
I	Punët Pregaditore	81,524.56 €
II	Punët e Gërmimit	309,910.70 €
III	Punët e Zhavorit	643,922.50 €
IV	Punët e Betonit (Guret Skajor dhe Kubzat)	366,778.00 €



V	Punët e Asfaltit	570,312.00 €
VI	Punët e tjera	30,000.00 €
VI	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit	4,700.00 €
Gjithsej totali me TVSH		2,007,147.76 €

Vërejtje: Objektet që gjinden në trasenë rrugës së projektuar demolohehen nga Investitori.

Projekti Kryesor i zgjerimit të rrugës hyrja nga Deçani, Gjakovë					
Paramasa dhe Parallogaria					
Lëshesa në stacionazhën 1+425.00 km Aksi 3					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I Punët Pregaditore					
1	Shenjëzimi dhe përcjellja e punimeve me gjeodet.	komplet	1.00	1,000.00	1,000.00 €
Gjithsej totali me TVSH					1,000.00 €
II Punët e Dheut					
1	Deviji i ujit gjatë realizimit të punimeve	komplet	1.00	500.00	500.00
2	Demolimi i leshesës egzistuese 20x5.8 m, bartja e materialit në deponinë e caktuar nga Investitori ose legale max 15 km	komplet	1.00	5,000.00	5,000.00
3	Gërmimi i dheut për ndërtimin e themeleve të leshesës dhe të krahëve, me transport deri 5 km në deponinë e caktuar nga Investitori ose legale	m³	444.00	3.50	1,554.00
2	Ngjeshja e nënbazës pas gërmimit deri në kotën e paraparë. Në këtë pozicion është përfshirë ngjeshja e nënbazës së themeleve dhe shtratit të ri të lumit. Për nënbazën e themeleve të urës, moduli i shafitjes duhet të jetë Msh>40 MN/mm².	m²	1,537.71	0.50	768.86
Gjithsej totali me TVSH					7,822.86
III Punët e Zhavorit					
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë 0-150mm nën themel t=30cm dhe anesh leshesës dhe lartësi h=2.50m	m³	166.00	12.00	1,992.00 €
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorrit 0-31.5mm, t=10 cm nën themel të urës	m³	28.70	13.00	373.10 €
Gjithsej totali me TVSH					2,365.10 €
IV Punët e Betonit					
1	Furnizimi dhe shtrirja e betonit të varfur C-16/20 nën themele të leshesës, me trashësi t=10 cm	m³	23.45	70.00	1,641.50 €
2	Furnizimi dhe betonimi i themeleve, mureve dhe pllakës të leshesës me beton C-30/37, duke përfshirë edhe punët e latimit.	m³	194.00	175.00	33,950.00 €
3	Furnizimi dhe betonimi i krahëve të leshesës dhe rregullimit të hyrjes dhe daljes dhe fundit të leshesave me beton C-30/37, duke përfshirë edhe punët e latimit	m³	8.20	175.00	1,435.00 €
Gjithsej totali me TVSH					37,026.50 €
V Punët i Armimit					
1	Furnizimi, punimi dhe vendosja e armaturës nga Ø 10 mm deri në Ø 14 mm	kg	13,350.80	1.40	18,691.12 €



Gjithsej totali me TVSH					18,691.12 €
VI	Punët e Hidroizolimit				
1	Hidroizolimi i Mureve dhe Krihve				
1	Furnizimi dhe lyrja e mureve, pllakës dhe kriheve me material hidroizolues (jo ujëpërshuesë-te lëngshëm), ne te dy anët.	m ²	892.00	5.00	4,460.00 €
Gjithsej totali me TVSH					4,460.00 €
VII	Punët Metalike				
1	Furnizimi dhe vendosja e ankerave për vendosjen e parmakëve (sipas detalit)	copë	8.00	50.00	400.00 €
2	Konstruktimi dhe montimi i paramakut te urë me lartësi h= 1.10 m (sipas detalit)	m'	18.00	25.00	450.00 €
3	Furnizimi dhe ngjyrosja e parmakeve te urë, ne tri shtrasa (baza dhe dy shtresa tjera)	m'	18.00	3.00	54.00 €
Gjithsej totali me TVSH					904.00 €
VIII	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit				
1	Testimet e betonit dhe armaturës	komplet	1.00	500.00	500.00 €
Gjithsej totali me TVSH					500.00 €

Rekapitullimi		
I	Punët Pregaditore	1,000.00 €
II	Punët e Dheut	7,822.86 €
III	Punët e Zhavorit	2,365.10 €
IV	Punët e Betonit	37,026.50 €
V	Punët i Armimit	18,691.12 €
VI	Punet e Hidroizolimit	4,460.00 €
VII	Punet Metalike	904.00 €
VIII	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit	500.00 €
Gjithsej totali me TVSH		72,769.58 €

Projekti Kryesor i zgjerimit të rrugës hyrja nga Deçani, Gjakovë		
Paramasa dhe Parallogaria		
